

V E N D I M

Nr. 806, datë 24.12.1998

PËR KTHIMIN E VLERAVE FINANCIARE KREDITORËVE QË KANË DEPOZITUAR KAPITALET APO LETRAT ME VLERË NË SHOQËRINË NË ADMINISTRIM “FLORA & CO” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shoqëria në administrim “Flora & Co”, sh.p.k., deri më 31 janar të vitit 1999, të përfundojë kthimin e vlerave financiare kreditorëve, që kanë depozituar pranë saj kapitalet apo letrat me vlerë.

2. Kreditorët, që kanë depozituar kapitalet apo letrat me vlerë pranë shoqërisë në administrim “Flora & Co”, sh.p.k., të paraqiten pranë administratorit të kësaj shoqërie, për njohjen e pretendimeve të tyre brenda datës 15 janar 1999.

3. Në përfundim të afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi dhe me përfundimin e shlyerjes së kreditorëve, administrimi i shoqërisë “Flora & Co” sh.p.k. konsiderohet i përfunduar. Në këtë rast, ndërmjet shoqërisë në administrim “Flora & Co”, sh.p.k. dhe të administratorit hartohet dokumentacioni përkatës i përfundimit të administrimit, të cilit i bashkëlidhet akti i kontrollit.

4. Ngarkohet Grupi Mbikëqyrës pranë Këshillit të Ministrave për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Pandeli Majko**